



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 78/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani, kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit nr. 485/2013 të datës 26.07.2013, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos emërimit të Zyrtarit Xhevat Ramadani në Komisionin Komunal Zgjedhor në Kamenicë për zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur më 02.08.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datën 01.08.2013, nga subjekti politik LDK dega në Kamenicë, më të cilën pretendohet se KQZ me vendimin nr. 485/2013 i datës 26.07.2013, ia ka mohuar të drejtën zyrtarit të nominuar nga subjekti politik LDK për tu emëruar si Zyrtar i Komisionit Komunal Zgjedhor në Kamenicë.

Parashtruesi i ankesës konsideron se me vendimin e lartpërmendur është bërë shkelje e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit personal.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e palejuar**

Meqenëse pretendimet ankimore nga parashtruesi i ankesës janë bërë për shkak se i nominuari i subjektit politik LDK nuk është emëruar nga KQZ-ja si Zyrtar në Komisionin Komunal Zgjedhor në Kamenicë, për zgjedhjet e 03.11.2013. PZAP-i duke u bazuar në nenin 63.6 të LZP-së, se vendimi i KQZ-së nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet çart me këtë ligj dhe neni 122.1 pikat a), b), c), d) e) dhe f) Apelimet Zgjedhore të LZP-së, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë në kompetencë të PZAP-it, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

A nr. 78/2013 më datën 02.08.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

